

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm**, Gjyqtari Kujtim Krasniqi, me zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit, Labinot Thaqi nga fshati M. Komuna e O., për shkak të veprës penale Rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesë spërdhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6296/2015, të datës 24.02.2017, jashtë seancës, me datë 29.03.2018, morikëtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.6296/2015, të datës 24.02.2017, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

### URDHËR NDËSHKIMOR

**I akuzuari;**

**L.Th.**, nga i ati H., i lindur më ..., me vendbanim në fshatin M. O., me nr.personal ..., Shqipëtar – shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse:**

Më datë 21.10.2015, rreth orës 10:30, në rrugën Prishtinë- Mitrovicë, saktësishtë pak pa arritur tek p. në fshatin M., ka ndodhur aksident trafiku, ku i pandehuri L.Th. shkeli Ligjin për Siguri në Komunikacionin Rrugor, nenin 55.1 dhe 126.1 të LSKRR, në atë mënyrë që i njetit duke drejtuar automjetin të tipit "Audi" A4, me targa ..., ngjyrë e bronzit, nga pakujdesia duke menduar me mendjelehtësi se deri të aksidenti nuk do të vij, ka rrezikur komunikacionin dhe ka vënë në rrezik jetën e njëzerveve, duke mos përshtatur kushtëve të krijuara dhe rregullave në komunikacion, në atë mënyrë që duke mabajtur distancën e mjaftueshme me pjesën e paërparme të automjetit të tij kishte goditur në pjesën e pasme automjetin e tipit "Audi" 85, me targa ..., ngjyrë e bronzit, të cilin e drejtonte Z.M.. Me ç'rast pos dëmeve materiale në të dy veturat kanë pësuar lëndime trupore të perkohshme për shëndetin drejtuesi i automjetit Z.M. dhe pasagjeret e tij, S.M., Sh.M., N.M.,

**Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

### DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) muaj nga dita e marrjes së formës së prere e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet:** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t'ia kompenzojnë shumën prej 40.88 euro në emër të ekspertizës së komunikacionit, 50 euro në emër të ekspertizës mjeko-ligjore dhe 30 euro në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

**I dëmtuari:** Z.M., me vendbanim në fshatin S. Komuna e V., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.6296/2015, të datës 24.02.2017, kundër të akzuarit L.Th. nga fshati M. Komuna e O., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akzuarve të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së Prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve sei akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit deklarata e të pandehurit, mendimi i ekspertit të komunikacionit Batri Sallahu të dt.14.10.2016, mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. D.H. dt.23.07.2016, si dhe fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, vërtetohet se e pandehura ka kryer veprën penale në datë, kohë, vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 të KPRK-së, për këtë edhe i'u shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i përgjithshëm-Penal  
P.nr.961/17, të dt. 29.03.2018

**Zyrtare ligjore,**  
Dafina Ymeri

**Gjyqtari,**  
Kujtim Krasniqi

### **KËSHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtimurdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.